

Партнерство за
Отворена
Власт на
**Северна
Македонија**



RAPORTIM I PAVARUR:

Republika e Maqedonisë së Veriut

FUSHA ME PRIORITET:

Parandalimi i korrupsionit dhe
promovimi i qeverisjes së mirë

RAPORT PËR IMPLEMENTIMIN:

tetor 2021 - gusht 2023

Marijana Jançeska, Fondacioni Metamorfozis





Во пресрет на подготовката на петтиот Национален акциски план за Партнерство за отворена власт 2021-2023 година (НАП за ПОВ 2021-2023), се формираше Мрежа на граѓански организации за ПОВ со цел поорганизирано делување и влијание на граѓанските организации на неговото креирање, како и поттикнување и мониторинг на имплементацијата на постојниот и идните акциски планови.

Со цел обезбедена вклученост на граѓанските организации во поддршка и следење на имплементацијата на НАП за ПОВ 2021-2023, Мрежата за ПОВ учествува и придонесува за воспоставување структура за координација и мониторинг на развојот и спроведувањето на НАП за ПОВ 2021-2023 обезбедувајќи независен мониторинг на имплементацијата.



Rezymeja përmbledhëse:	
Republika e Maqedonisë së Veriut -	
Qasja te drejtësia	5
I. Hyrja	8
II. Implementimi i planit aksional -	
Parandalimi i korrupsionit dhe promovimi	
i qeverisjes së mirë	10
III. Metodologjia dhe burimet	22
Aneksi I.	23
Pasqyra e implementimit të Parandalimit të të	
korrupsionit dhe promovimit të qeverisjes së mirë	23
Aneksi II.	26
Burimet/materialet për verifikim	26


Ekzemplarin e këtij raporti e përpiloi Darko Antiq nga Shoqëria ESE në bazë të ekzemplarëve të raportit të MRP-së (mekanizmi për raportim të pavarur). Ekzemplari është përpiluar për përgatitje të raporteve, të cilat janë pjesë e procesit për vlerësim dhe monitorim të pavarur të Planit Aksional për PQH të Republikës së Maqedonisë së Veriut nga përfaqësuesit e organizatave qytetare të cilat janë anëtare të Rrjetit Nacional të OQ-ve për PQH.



Association for emancipation,
Solidarity and equality
of women - ESE

REZYMEJA PËRMBLEDHËSE

Republika e Maqedonisë së Veriut -
Parandalimi i korrupsionit dhe
promovimi i qeverisjes së mirë



Tri angazhimet që janë pjesë të fushës prioritare Parandalimi i korrupsionit dhe promovimi i qeverisjes së mirë përparojnë mirë. Edhe pse momentalisht vetëm një ka përfunduar tërësisht, kurse dy janë në fazën e implementimit, vihet re ndryshim në klimën politike dhe motivim për zbatim të obligimeve të ndërmarra nga institucionet shtetërore.

Trysnia e vazhdueshme nga organizatat qytetare të cilat punojnë në fushën e antikorrupsionit, të dhënave të hapura dhe promovimit të transparencës dhe qeverisjes së mirë u dëshmuar si kyçe për përparimin në këtë fushë prioritare. Mbështetja financiare gjatë prokurimit të zgjidhjeve softuerike ka ndikim pozitiv, por vihet re promovim i pamjaftueshëm i ndryshimeve, përkatësisht lajmi për zbatimin e tyre nuk arrin të përdoruesit përfundimtarë.

Me shpalljen publike të lëndëve për zgjedhjen e funksionarëve të zgjedhur dhe të emëruar nga Qeveria e RMV-së si udhëheqës të institucioneve do të përparohet jo vetëm transparenca por edhe besimi i qytetarëve në kapacitetet e institucioneve. Ky angazhim është angazhim yjor në ndikimin afatgjatë pozitiv mbi shoqërinë.

PASQYRË E PËRGJITHSHME E FUSHËS PRIORITARE

→ Në fushën prioritare janë tri angazhime prej të cilave një ka përfunduar, kurse dy janë në procesin e implementimit. Përfshirja e shoqërisë qytetare është kyçe dhe e përhershme sepse të tri angazhimet janë propozuar dhe po zbatohen në bashkëpunim me organizata qytetare relevante.

→ Shpallja e marrëveshjeve të lidhura në format të hapur çon në llogaridhënien dhe sigurinë më të madhe në profesionalizmin e procesit. Promovimi i tyre përkatës si opsion duhet të sjellë përdorim më të madh nga gazetarët hulumtues, sektori i biznesit dhe shoqëria qytetare.

TABELA 1.

PASQYRË E SHPEJTË

Ky prioritet ekziston nga : tetori i vitit 2021, por ndërlidhet me prioritetet Integriteti dhe menaxhimi i mirë dhe Transparenca financiare e PAN 4

Periudha e implementimit, që është lëndë e raportimit:
tetor 2021 - gusht 2023

Numri i angazhimeve në suazat e prioritetit: 3

ZHVILLIMI I PRIORITETIT

Niveli i hapjes dhe pjesëmarrjes: i hapur

Zëri i OQ-ve: ndikim i madh

Përfshirja e institucioneve publike: e madhe

IMPLEMENTIMI

Angazhime të miratuara: 3 (100 %)

Angazhime të realizuara tërësisht: 1 (33 %)

Niveli i bashkëpunimit me OQ-të dhe institucionet publike: i lartë

PESË REKOMANDIME KRYESORE

Ato kanë për qëllim të informojnë zhvillimin e angazhimeve, të cilat janë pjesë e prioritetet që vlerësohet në planin e ardhshëm aksional dhe ta drejtojnë zbatimin e planit aktual aksional. Monitorimi rekomandon si më poshtë:

Baza e prokurimeve publike të hapura të zgjerohet dhe përveç marrëveshjeve të lidhura t'i përmbajë edhe anekset, planet për prokurimet publike dhe shpalljet.

Të përgatiten dhe të vizualizohen analiza duke përdorur bazën e prokurimeve publike në format të hapur që të mund t'i prezantohet publikut përdorimi i tyre dhe të ndërtohet imazhi si mund të përdoren.


Të vendoset në funksion zgjidhja softuerike e cila përfshin modul për paraqitje të lehtë të gjendjes anketuese dhe transparencës së ndryshimit të gjendjes pronësore nëpër kohë.

Të fillojë shpalljen e lëndëve të personave të emëruar/zgjedhur në portalin e të dhënave të hapura.

PËR AUTORIN


Marijana Jançeska është magjistër i shkencave kulturologjike dhe ka përfunduar shumë studime të specializuara në fushën e menaxhimit të komunikimeve. Karriera e saj në sektorin qytetar përfshin përvojë shumëvjeçare si koordinatore e granteve, koordinatore e projekteve dhe specialist për monitorim dhe evoluim. Shfaqet si redaktore, autore dhe përkthyes e shumë publikimeve.

Në ekipin e Fondacionit Metamorfozis u përfshi në dhjetor të vitit 2020 dhe punon si specialiste për nxitjen e hapjes dhe pjesëmarrjes.






I. HYRJA



Partneriteti për qeverisje të hapur është iniciativë globale e cila i bashkon reformatorët e pushtetit dhe liderët e shoqërisë qytetare në krijimin e planeve aksionale që pushteti të jetë më inkluziv, më i përgjegjshëm dhe më llogaridhënës. Angazhimet e planit aksional në fushën prioritare Parandalimi i korrupsionit dhe promovimi i qeverisjes së mirë mund të mbindërtohen mbi angazhimet ekzistuese, të identifikojnë hapa të rinj për realizimin e reformave aktuale ose të iniciojnë aksion në një fushë krejtësisht të re. Monitorimi i pavarur i angazhuar për përpilimin e këtij raporti zbatoi një sërë aktivitete për vlerësimin e implementimit të angazhimeve që të sigurohet se pushteti do të mbetet i përkushtuar në zbatimin e tyre. Liderët e shoqërisë qytetare dhe të pushtetit i përdorin këto evalvime që të reflektojnë mbi përparimin personal dhe të përcaktojnë se a ndikojnë aksionet e ndërmarra mbi jetën e njerëzve.

Republika e Maqedonisë së Veriut merr pjesë në PQH nga viti 2011 dhe deri më tani ka miratuar pesë plane aksionale. Plani i pestë aksional (2021 – 2023) e tejkalon ambicien e planeve të mëparshme, sidomos në lidhje me transparencën e prokurimeve publike, dërgimin e shërbimeve publike dhe qasjen te drejtësia për grupet vulnerable. Zbatimi i tërësishëm i planit mund ta bëjë Republikën e Maqedonisë së Veriut lidere rajonale në Ballkanin Perëndimor në fushat kryesore të qeverisjes së hapur dhe t'i adresojë prioritetet e procesit të aderimit në BE.



Duke pasur parasysh spektrin dhe vëllimin e planit aksional, nevojitet bashkëpunim i ngushtë midis institucioneve publike dhe shoqërisë qytetare në arritjen e rezultateve të rëndësishme. Angazhimet e Planit të pestë aksional të Republikës së Maqedonisë së Veriut janë organizuar në pesë fusha tematike: transparenca, antikorrupsioni, dërgimi i shërbimeve publike, qasja te drejtësia dhe mjedisi jetësor dhe ndryshimet klimatike. Angazhimet mbulojnë një numër të madh temash duke përfshirë edhe prokurimet publike, ndjekjen e paraqitjeve të gjendjes pronësore të funksionarëve publikë, integrimin e prioriteteve qytetare në dërgimin e shërbimeve publike dhe përforcimin e qasjes te ndihma juridike pa pagesë. Republika e Maqedonisë së Veriut po e zbaton edhe planin e saj të dytë për parlament të hapur dhe planin e parë aksional për gjyqësor të hapur për përforcim të transparencës së pushtetit gjyqësor.

Vlerësimin e bën monitoruesja e pavarur Marijana Jançeska nga Fondacioni Metamorfozis, e cila e ka bërë këtë evalvim. Raporti ka për qëllim ta informojë dialogun aktual për zhvillim dhe zbatim të angazhimeve të ardhshme.

Ky raport e përfshin implementimin e angazhimeve në suazat e Parandalimit të korrupsionit dhe promovimin e qeverisjes së mirë të planit të pestë aksional të Republikës së Maqedonisë së Veriut për periudhën 2021 - 2023.

Në Raportin e Komisionit Evropian për Republikën e Maqedonisë së Veriut për vitin 2022¹ thuhet se ajo i ka vazhduar përpjekjet e veta për përfundim të demokracisë dhe sundimit të së drejtës. Institucionet e kanë dëshmuar përkushtimin e vet që të arrijnë rezultate në klasterin “Themele”, por përparim është arritur edhe nëpërmjet agjendës “Evropa në shtëpi”. Bllokada nga Republika e Bullgarisë i ka ndezur dilemat e brendshme pa përgjigje, por edhe e nxiti Qeverinë të drejtohet kah bashkëpunimit të zmadhuar rajonal nëpërmjet iniciativës “Ballkani i hapur”. Në janar të vitit 2022 është zgjedhur Qeveria e re në Republikën e Maqedonisë së Veriut, e cila mori obligimin “të udhëhiqet nga parimet themelore dhe të përparuar të menaxhimit të mirë me përgjegjësi, efikasitet, llogaridhënie, punë të ndershme, inkluzivitet dhe qasje”². Anëtar i rëndësishëm i përbërjes së Qeverisë së re është përzgjedhja e zëvendëskryeministrit të Qeverisë i ngarkuar për politikën për qeverisje të mirë, që është paraparë për shkak se “krijimi dhe zbatimi i politikave për qeverisje të mirë të jenë imperativ, në drejtim të sigurimit të profesionalizmit, efikasitetit dhe transparencës në shoqëri”³. Sipas Vlerësimit të qeverisjes së mirë në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe në rajon nëpërmjet Indeksit të hapjes⁴, më e hapur është Qeveria

e Republikës së Maqedonisë së Veriut, e cila plotëson 82,71% të kriterëve të vendosura për hapje, pas së cilës vijon Qeveria e Malit të Zi me 58,16%. Në vendin e tretë është BeH me 49,58%. Qeveria e Republikës së Serbisë është në vendin e fundit me plotësim të 37,96% të kriterëve për hapje. Hapja dhe transparenca e pushteteve është një nga çështjet kyçe në reformën e administratës publike dhe procesit të integritetit evropian të cilin po e kryejnë vendet e Ballkanit Perëndimor. Pyetja e transparencës së konsumit publik u dëshmuar si veçanërisht e ndjeshme, kurse nevoja për përfshirjen e qytetarëve dhe sektorit qytetar në krijimin e politikave dhe vendimmarrjes meriton apel.


Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut iu bashkëngjiti iniciativës të Partneritetit për qeveri të hapura (Partneritet për qeverisje të hapura) dhe më 01.06.2012 e miratoi Planin e parë aksional duke u bërë kështu anëtare e plotfuqishme. Prej atëherë, Republika e Maqedonisë së Veriut ka miratuar pesë plane aksionale për Partneritet për qeverisje të mirë (2012, 2014, 2016, 2018 dhe 2021). Angazhimet e monitoruara janë pjesë e planit të fundit aksional për vitin 2021 - 2023 dhe kanë të bëjnë me fushën Parandalimi i korrupsionit dhe promovimi i qeverisjes së mirë.

¹ <https://www.sep.gov.mk/post/?id=5657#.Y20M03bMJPY>

² http://vlada.mk/sites/default/files/programa/2022-2024/programa_na_vladata_2022-2024.pdf

³ Ibid.

⁴ https://metamorphosis.org.mk/izdanija_arhiva/procenka-na-dobroto-vladeenje-vo-severna-makedonija-i-regionot-preku-indeksot-na-otvorenost-sobranie-i-izvrshna-vlast-merenje-za-2021/



II. IMPLEMENTIMI I PLANIT AKSIONAL - PARANDALIMI I KORRUPSIONIT DHE PROMOVIMI I QEVERISJES SË MIRË

2.1. PASQYRË E PLANIT AKSIONAL - PARANDALIMI I KORRUPSIONIT DHE PROMOVIMI I QEVERISJES SË MIRË


Plani aksional në fushën me prioritet Parandalimi i korrupsionit dhe promovimi i qeverisjes së mirë është përgatitur në bashkëpunim dhe partneritet me shoqërinë qytetare. Niveli i hapjes së procesit ishte i lartë dhe të gjitha angazhimet e propozuara janë pranuar pasi janë përpunuar dhe plotësuar në mënyrë përkatëse.

Fusha prioritare Parandalimi i korrupsionit dhe promovimi i qeverisjes së mirë përmban tri angazhime: Prokurimet publike si të dhëna të hapura; Mekanizëm i përparuar për ndjekjen e gjendjes pronësore të funksionarëve të emëruar dhe zgjedhur; Shpallja publike e lëndëve për zgjedhjen e zyrtarëve të emëruar/zgjedhur nga Qeveria e RMV-së si udhëheqës të institucioneve. Nga këto tri angazhime, një është përfunduar tërësisht, kurse dy të tjerat janë në procesin e implementimit. Të tri angazhimet përfshijnë zgjidhje softuerike, përkatësisht digjitalizim të pjesshëm ose të tërësishëm të procesit. Faktorë të cilët padyshim e përshpejtuan procesin janë mbështetja financiare dhe logjistike nga shoqëria qytetare, kurse vullneti politik mund të konsiderohet si frenim në rastin e angazhimit të tretë – Mekanizëm i përparuar për ndjekjen e gjendjes pronësore të funksionarëve të zgjedhur dhe të emëruar.

Këto tri angazhime mund të konsiderohen si angazhime të jashtëzakonshme, përkatësisht yjore që do të kishin ndikim të madh pozitiv mbi shoqërinë.

2.2. ANGAZHIMET

I. Prokurimet publike si të dhëna të hapura




RAPORTI PËR DIZAJNIN	RAPORTI PËR IMPLEMENTIMIN
1. Angazhimi është zhvilluar nëpërmjet procesit të hapur dhe konsultues me pjesëmarrje të palëve të prekura relevante: PO	1. Statusi i implementimit: i përfunduar
2. Angazhimi është relevant për PQH-në: PO qasje tek informacionet, pjesëmarrja qytetare, llogaridhënia publike	2. Angazhimi ka sjellë ndryshime në sektorin publik: PO

Prokurimet publike shpeshherë janë vendi ku mund të zbatohen praktika korruptuese nga më të ndryshmet. Nëpërmjet shpalljes së tyre në format të hapur zvogëlohet mundësia për korrupsion, sepse vëmendja e publikut është më e mprehtë, kurse ekspertëve për të dhëna të hapura dhe gazetarëve investigues u jepet një mjet për ndjekje të përhershme të proceseve. Qëllimi i këtij angazhimi është përmirësimi i llogaridhënies së prokurimeve publike nëpërmjet mundësisë së zmadhuar për mbikëqyrje të jashtme nga mediat dhe organizatat joqeveritare. Ky angazhim parashikon shpellje të prokurimeve publike në format të lexueshëm nga makineria, si dhe të dhëna të hapura në portalin qeveritar kushtuar këtij qëllimi.

Në lidhje me prokurimet publike si të dhëna të hapura ishte e rëndësishme të mësohet a është zhvilluar baza e prokurimeve publike në format të hapur; sa nga furnizimet publike në format të hapur janë në dispozicion në sajtin zyrtar dhe a janë ato të hapura në mënyrë proaktive nga institucionet ose si pjesë e projektit. Përveç kësaj, u parashtrua pyetja a i plotësojnë të dhënat e shpallura kriteret e portalit www.data.gov.mk dhe a janë të përdorshme për bashkësinë e biznesit dhe për të gjithë entuziastët për të dhënat.

U zbatuan intervista me Misha Popoviqin nga Instituti për demokraci “SocietasCivilis” dhe Goran Davidovskin nga Byroja për prokurimet publike.



Ueb-faqja e Byrosë për prokurime publike është përmirësuar dhe mbindërtuar, por vihen re dallime të caktuara në cilësi nëse përdoren shfletues të ndryshëm në internet, për shembull, Mozilla, Exh (Edge), Eksploror (Explorer). Në këtë faqe nëpërmjet një butoni të veçantë në faqen e parë me titull të dhëna të hapura - hapet dritare e re me të gjitha të dhënat e hapura në dispozicion. Zgjidhja softuerike jep pasqyrë të të dhënave të ndara në këto grupe: shpallje, marrëveshje, ankande, anulime dhe konsumatorë. Të dhënat prezantohen nëpërmjet tabelave të ndryshme, grafikëve dhe vizualizimeve të ndryshme, kurse nëpërmjet filtrave mund të kërkohen në nivel mujor, tremujor ose vjetor.

Plotësimi i ri i këtij portali ofron zbritjen e formatit të hapur të marrëveshjeve të veçanta apo serisë së marrëveshjeve të përzgjedhura nëpërmjet disa parametrave. Zgjidhja e përpiluar nga BPP-ja në komunikim me Institutin për demokraci “SocietasCivilis”, kurse është zbatuar nga kompania softuerike e cila mirëmbajtëse aktuale e ueb-faqes së Byrosë për prokurimet publike. Ajo që mungon si informacion momentalisht është fakti se sa herë janë marrë të dhëna në format të hapur, si dhe për se janë përdorur të dhënat e marra. Në bisedë me përfaqësuesin e Byrosë për prokurime publike u shpjegua se qëllimi kryesor i të dhënave të hapura është të jenë të përdorshme për bashkësinë e biznesit, por momentalisht nuk posedojnë informacion sa prej tyre janë ripërdorur.

Provuam të marrim një seri marrëveshjesh të lidhura dhe marrëveshjen e vendosur në sajt për hapat që duhet të ndërmerren që të konvertojë fajl nga csv në excel ishte mjaft e dobishme. E gjithë procedura u krye lehtë dhe thjesht.

Setet e shpallura të të dhënave janë në format të përmbledhur, pastaj varet nga përdoruesi sa do jetë inovator dhe në cilën mënyrë do t'i tregojë. Megjithatë, nevojitet pastrim i pjesshëm i të dhënave para vizualizimit të tyre apo prezantimit në format tjetër grafik.

II. Mekanizëm i përparuar për ndjekjen e gjendjes pronësore të funksionarëve të zgjedhur dhe të emëruar

RAPORTI PËR DIZAJNIN	RAPORTI PËR IMPLEMENTIMIN
1. Angazhimi është zhvilluar nëpërmjet procesit të hapur dhe konsultues me pjesëmarrje të palëve të prekura relevante: PO	1. Statusi i implementimit: në vijim
2. Angazhimi është relevant për PQH-në: PO qasje tek informacionet, qasje tek informacionet, pjesëmarrja qytetare, llogaridhënia publike	2. Angazhimi ka sjellë ndryshime në sektorin publik: PO

Mekanizmi funksional për evidentimin dhe ndjekjen e gjendjes pronësore të funksionarëve të zgjedhur çon në zvogëlimin dhe parandalimin e pasurimit të jashtëligjshëm të funksionarëve të zgjedhur dhe emëruar. Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit është mjaft i kufizuar në lidhje me evidentimin dhe ndjekjen e gjendjes pasurore të funksionarëve, kurse ekziston edhe efikasitet i pamjaftueshëm në ndjekjen e gjendjes së tyre pronësore. Momentalisht, regjistri i funksionarëve të emëruar dhe zgjedhur nuk e ka realizuar tërësisht funksionin për të cilin është vendosur dhe KSHPK-ja nuk ka mbikëqyrje të tërësishme mbi numrin e përgjithshëm të funksionarëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Qëllimi kryesor i këtij angazhimi është vendosja e sistemit funksional i cili do ta thjeshtëzojë kontrollin e gjendjes pronësore dhe interesave të funksionarëve të zgjedhur dhe emëruar dhe do t'u sigurojë qytetarëve mbikëqyrje përkatëse në gjendjen pronësore dhe interesat e funksionarëve të zgjedhur dhe emëruar dhe pasqyrë mbi ndryshimet e ndodhura në periudhën që ata e ushtrojnë funksionin.

Pyetjet që ishte e rëndësishme t'u jepet përgjigje në lidhje me mekanizmin e përparuar për ndjekjen e gjendjes pronësore të funksionarëve të zgjedhur dhe emëruar janë se a është kompletuar zgjidhja softuerike dhe çfarë përfshin. Në bazë të përgjigjeve të marra, pyetëm dhe kur pritet të jetë gati dhe cilat janë sfidat me të cilat janë ballafaquar gjatë realizimit. U bënë intervista me Misha Popoviqin nga Instituti për demokraci "SocietasCivilis" dhe Borçe Stojanovskin nga Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit. Dizajnimi i zgjidhjes së përmirësuar softuerike është në vijim. Shembulli është bërë në bazë të përvojës së deritanishme dhe t do të mbartet vetëm fleta e anketimit në formë elektronike, domethënë sipas formës tashmë të përcaktuar të deklaratës së gjendjes pronësore. Përmbajtja është përcaktuar, kurse mbetet për t'u përcaktuar vetëm forma, sepse ajo varet nga zgjidhja softuerike. Ka vend për modifikime të imëta në vetë formular për të futur kriptovalutat. Përfaqësuesi i intervistuar i KSHPK-së beson se zgjidhja softuerike duhet të finalizohet dhe të vihet në përdorim deri në fund të vitit. Një pjesë është përgatitur (regjistri i funksionarëve të zgjedhur/emëruar) dhe në momentin e përgatitjes së këtij raporti është bërë trajnimi për personat nga Sekretariati i përgjithshëm i Qeverisë. Implikimet financiare janë nëpërmjet një projekti për të cilin përfaqësuesi i KSHPK-së nuk ishte i informuar në detaje. Ideja është që aplikimet të dorëzohen në mënyrë elektronike, kurse verifikimi të bëhet me një formular të printuar. Në vijim është edhe iniciativa për ndryshimin e Ligjit, përkatësisht në pjesën ku thuhet se pyetësi dorëzohet në formë elektronike ose në letër, fshihet forma në letër dhe do të mbetet vetëm forma elektronike.

III. Shpallja publike e lëndëve për zgjedhjen e funksionarëve të emëruar/zgjedhur nga Qeverisë së RMV-së si udhëheqës të institucioneve


RAPORTI PËR DIZAJNIN	RAPORTI PËR IMPLEMENTIMIN
1. Angazhimi është zhvilluar nëpërmjet procesit të hapur dhe konsultues me pjesëmarrje të palëve të prekura relevante: PO	1. Statusi i implementimit: në vijim
2. Angazhimi është relevant për PQH-në: PO qasje tek informacionet, qasje tek informacionet, pjesëmarrja qytetare, llogaridhënia publike	2. Angazhimi ka sjellë ndryshime në sektorin publik: PO

Funksionarët e zgjedhur dhe të emëruar nga Qeveria e RMV-së si udhëheqës të institucioneve përfaqësojnë shtresën më të lartë meritokratike në administratën shtetërore. Megjithatë, praktika është e ndryshme nga standardet dhe vite me radhë përzgjedhja e kuadrit mbetet në pjesën më të madhe joformale, me emërim të ushtruesit të detyrës pse me nivel të ulët të kompetencës, përkatësisht shpallje vetëm me një kandidat. Kuadri udhëheqës joprofesional nuk kontribuon në zhvillimin institucionit, sepse nuk di të përzgjedhë dhe menaxhojë zgjidhjen e problemeve me të cilat ballafaqohet. Përveç kësaj, me mospërdorimin e sistemit të meritës në emërim demotivohen kuadrot profesionale në vetë institucion, si dhe ekspertët e jashtëm që shpresojnë se mund t’ia dalin në shpallje publike të marrin shansin që të udhëheqin institucion publik. Qëllimi kryesor i angazhimit është shpallja e lëndës për përzgjedhje të funksionarit të zgjedhur ose emëruar (shpallja e publikuar nëse ka, propozimi i Komisionit për emërim, Vendimi i Qeverisë, biografia e funksionarit të zgjedhur apo emëruar, matrica për vetevaluim, letra motivuese dhe programi i punës).

Këtu ishte e rëndësishme për ne të dimë a është përgatitur listë e dokumenteve standarde dhe shtesë për shpalljen e një lënde, si dhe të mësojmë si ka vijuar procesi i zbatimit. U mbajtën takime me Maja Petkovska Leser nga Sekretariati i përgjithshëm i Qeverisë dhe me Misha Popoviqin nga Instituti për demokraci “Societas Civilis”. Takimi i fundit i palëve të prekura për këtë angazhim u mbajt në mars të vitit 2022 dhe momentalisht nuk ka lëvizje të punëve. Një pjesë e arsyeve për këtë mosaktivizim është mungesa e vullnetit politik, por edhe migracioni i kuadrove në administratën shtetërore. Lista e dokumenteve që duhet t’i përmbajë një lëndë e shpallur është finalizuar, por duhet të dorëzohet në Qeveri për vendim final. Lista e funksionarëve të zgjedhur i përmban këto informacione: linkun e publikuar të shpalljes, propozimin e Komisionit për emërim, biografinë e funksionarit të zgjedhur/emëruar, letrën motivuese të funksionarit të emëruar/zgjedhur dhe programin e punës, tabelën dhe të dhënat statistikore për

konkursin (sa janë paraqitur, fletëparaqitje të rregullta/parregullata, fletëparaqitje në kohë/jo në kohë etj.). Lista për funksionarët e emëruar e përmban edhe biografinë e funksionarit të zgjedhur dhe vendimin për emërim, kurse kjo vlen edhe për emërimin e ushtruesve të detyrës.

Në bisedë me përfaqësuesin e Sekretariatit të përgjithshëm u vu re se disa institucione i shpallin lëndët për zgjedhje të funksionarëve të emëruar/zgjedhur, por vetëm me iniciativën e vet dhe proaktivisht, sepse nuk ka vendim nga Qeveria. Ky nuk është angazhim që ka fillim dhe fund, por do të realizohet vazhdimisht me të kaluar në Qeveri, kurse mandej do të vlejë dhe në mënyrë retroaktive për të gjithë funksionarët e zgjedhur/emëruar në mandatin e Qeverisë së tanishme. Sipas informacioneve nga Sekretariati i përgjithshëm, momentalisht ka rreth 55 funksionare për të cilët përgatiten lëndë. Pritet të përfundojnë të gjitha procedurat deri në fund të dhjetorit 2022 dhe lëndët të fillojnë të shpallen në vitin 2023.





III. METODOLOGJIA DHE BURIMET



Procesi i monitorimit i përmbante këto aktivitete::

- Shqyrtimin e angazhimeve dhe lidhjen e tyre me planet e mëparshme aksionare;
- Zbatimin e intervistave me të gjitha palët e prekura (përfaqësues të organizatave qytetare dhe personat përgjegjës në institucionet shtetërore);
- Shqyrtimin e kornizës ligjvënëse dhe lidhjen me angazhimet e tjera;
- Plotësimin e matricës për monitorim;
- Përgatitjen e propozim-raportit

ANEKSI I.

PASQYRA E IMPLEMENTIMIT TË PARANDALIMIT TË KORRUPSIONIT DHE PROMOVIMIT TË QEVERISJES SË MIRË

Legjenda



E GJELBËR = i realizuar (i përfunduar)



E VERDHË = në vijim (vetëm nëse ndërmerren të gjithë hapat e nevojshëm dhe angazhimi do të realizohet)



E KUQE = angazhim i pafilluar ose i filluar, por nuk ka përparim në implementim

Numri (njëjtë si në PA)	Emri i angazhimit	Emri i aksioneve	Statusi i realizimit
2.1.	Prokurimet publike si të dhëna të hapura	<p>6.1.1 Përgatitja e planit për shpallje, i cili përfaqëson strukturën e setit të të dhënave dhe përzgjedhjen e informacioneve që do të shpallen për çdo prokurim publik.</p> <p>6.1.2 Shpallja në bazën e portalit të dhëna të hapura</p>	
2.2.	Mekanizëm i përparuar për ndjekjen e gjendjes pronësore të funksionarëve të zgjedhur dhe emëruar	<p>6.2.1 Kompletimi i zgjidhjes softuerike për regjistër dhe fletë anketuese</p> <p>6.2.2 Faza initiale e mbledhjes së të dhënave</p>	
2.3.	Shpallje publike e lëndëve për zgjedhje të funksionarëve të emëruar/ zgjedhur nga Qeveria e RMV -së si udhëheqës të institucioneve	<p>2.3.1 Përgatitja e listës së standardeve dhe dokumentet shtesë për shpalljen e një lënde</p> <p>2.3.2 Shpallja e lëndëve për emërim të funksionarëve të zgjedhur/emëruar në portalin e të dhënave të hapura</p>	


ANEKSI II.

BURIME / MATERIALE PËR VERIFIKIM

1. Video e takimit të mbajtur me Borçe Stojanovskin, përfaqësuesin e KSHPK-së;
2. Video e takimit të mbajtur me Misha Popoviqin, Instituti për demokraci “SocietasCivilis”;
3. Video e takimit të mbajtur me Goran Davidovskin, përfaqësuesin e Byrosë për prokurimet publike;
4. Video e takimit të mbajtur me Maja Petkovska Leses, përfaqësuese e Sekretariatit të përgjithshëm të Qeverisë së RMV-së;
5. Korrespondencë me mail me Borçe Stojanovskin, përfaqësuesin e KSHPK-së;
6. Korrespondencë me mail me Misha Popoviqin, Instituti për demokraci “SocietasCivilis”;
7. Korrespondencë me mail me Goran Davidovskin, përfaqësuesin e Byrosë për prokurimet publike;
8. Korrespondencë me mail me Maja Petkovska Leses, përfaqësuese e Sekretariatit të përgjithshëm të Qeverisë së RMV-së.

MATERIALET E PËRDORURA

1. Microsoft Word - for web_2019-21-Design-Report-Template.docx (opengovpartnership.org)
2. Microsoft Word - for web_Implementation-Report-2017-19-APs-template_to-use-updated-12-17-19.docx (opengovpartnership.org)
3. IRM Reports and Analysis (opengovpartnership.org)
4. IRM Guidelines for the Assessment of Minimum Requirements (opengovpartnership.org)
5. NAP5-PARTNERSTVO-ZA-OTVORENA-VLAST-2021-2023-_-potvrden-od-Vlada-26.10.2021.pdf (ovp.gov.mk)



Procesi është mbështetur nga Sekretariati i PQH- së për nevojat e projektit “Mbështetje e procesit të zbatimit dhe ndjekjes së Planit nacional aksional për Partneritet për qeverisje të hapur 2021 - 2023”, të cilin e zbaton Fondacioni Shoqëria e Hapur - Maqedonia në partneritet me Qendrën për komunikime qytetare dhe Shoqatën për emancipim, solidaritet dhe barazi të grave, në bashkëpunim me Ministrinë për Shoqëri Informatike dhe Administratë.